



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Komunitete

Nr. 02-060/01-0011284-1/25 dt. 27.02.2025

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete
Seanca e 37-të

Koha: 27.02.2025 ora 15:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Jeton Rrahmani, Xhafer Preteni, Majlinda Kurti, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi, Gazmend Asllani, Ardita Aliu, Agron Jashari, Esat Krasniqi, Habib Hajdini dhe Ancsa Collaković
Drejtori i DKRS-së: z. Fahri Jashari

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Komitetit i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot është thirrur mbledhja e rregullt të Komitetit për Komunitete me këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Diskutim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Qendrën e Komuniteteve

Rendi i ditës u miratua unanimisht

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani: Së pari, e falënderoj Drejtorinë dhe z. Jashari që janë përgjegjës ftesës sonë. Sa i përket diskutimit me DKRS-në lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Qendrën e Komuniteteve, fillimisht dua t'i përmbledh shqetësimet tona dhe t'i shpreh, ndërsa pastaj besoj që ju keni informacione më të detajuara dhe mund të na i paraqitni. Bëhet fjalë për një qendër e cila është ndërtuar para disa vitesh si donacion nga Komuniteti Turk. Nuk po hyj në detaje, por ajo njihet kryesisht për faktin që menaxhohet nga Komuniteti Turk. Aty operojnë disa organizata. Drejtor, unë po e bëj një përmbledhje të shkurtër: Problematika, sipas disa informacioneve dhe diskutimeve që kemi pasur rreth komitetit, lidhet me disa çështje që, me siguri, si drejtori përkatës i keni të njohura dhe mund të na ndihmoni për të parë si mund të trajtohen më mirë. Siç e përmenda, bëhet fjalë për Qendrën e Komuniteteve që gjendet pas restorantit "Babiano". Është një qendër e ndërtuar me donacion nga Komuniteti Turk dhe, sipas asaj që dimë, menaxhohet nga organizata "Birlik", që përfaqëson po ashtu komunitetin turk. Aty operojnë edhe OJQ "PRAMI" nga komuniteti ashkali dhe një organizatë tjetër nga komuniteti boshnjak – emri mund të jetë "Sarajë", nëse nuk gaboj, e përfaqësuar nga znj. Armina Molliqi. Problemet që kemi identifikuar janë këto: Shpenzimet komunale – Sipas një kërkesë që kemi marrë nga menaxhmenti i Qendrës së Methankës (siç thuhet), kanë vështirësi me mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike, ujit dhe të tjera. Duhet parë si mund të ndihmojë komuna në këtë drejtim. Çështja e menaxhimit – Ka paqartësi në lidhje me menaxhimin e qendrës. Thuhet se është nën menaxhimin e organizatës "Birlik", por sipas informatave që kemi, nuk bëhet fjalë për një menaxhim të zgjedhur zyrtarisht apo në mënyrë të organizuar. Ka probleme të natyrave të ndryshme. Organizatat joaktive – Ka organizata që kanë vite të tëra pa asnjë aktivitet, por që ende posedojnë çelësat e zyrave. Në disa raste, këto hapësira janë përdorur gjatë fushatave për qëllime politike, gjë që është e papranueshme. Përfundimisht, ajo që është me rëndësi, Drejtor, është që Drejtoria ta shqyrtojë situatën në tërësi dhe të ofrojë një zgjidhje adekuate. Kjo është një qendër me potencial të madh për zhvillimin e aktiviteteve të dobishme për të gjitha komunitetet që janë pjesë e qytetit të Mitrovicës. Fillimisht po ia kaloj fjalën juve, e më pas mund ta hapim diskutimin edhe për kolegët e tjerë.

Fahri Jashari: Përshëndetje për të gjithë! Është hera e parë që marr pjesë në një diskutim të tillë me Komitetin për Komunitete, dhe e vlerësoj shumë ftesën. Kjo është me rëndësi si për ju si komitet, ashtu edhe për ne si ekzekutiv, përkatësisht si Komunë e Mitrovicës. Në fakt, bëhet fjalë për një qendër për komunitetet, e cila është ndërtuar rreth dhjetë vite më parë, si një bashkëfinancim midis Ministrisë së Kulturës, organizatës Jenisofo dhe Komunës së Mitrovicës. Pas disa viteve funksionimi, kjo qendër ka filluar të përballlet me një sërë problemesh të brendshme dhe, në një farë mënyre, me dështime që lidhen me menaxhimin e saj. Nga ajo që kemi vërejtur në rolin tonë si drejtori, menaxhimi i deritanishëm është i dobët. Kjo ndodh

pjesërisht për shkak se vetë komunitetet që e përdorin nuk e kanë trajtuar si duhet përgjegjësinë për mirëmbajtje dhe menaxhim. Në fillim kam pasur shpresë që gjërat do të ndryshojnë, por realiteti ka treguar se pa veprime konkrete nuk mund të kemi përmirësim. Shpresoj që ky diskutim të sjellë sugjerime dhe veprime konkrete për të ardhmen e qendrës. Sa i përket çështjeve komunale dhe kërkesave të tyre, e di që vitin e kaluar kemi përmbyllur të gjitha pagesat që kanë qenë në obligim të komunës. Problemi kryesor ka qenë me energjinë elektrike, ndonëse herë pas here është raportuar edhe për probleme me ujin dhe shërbime të tjera. Dua të theksoj se, kjo qendër duhet t'u shërbejë të gjitha komuniteteve që jetojnë në Mitrovicë, jo vetëm njërit komunitet të caktuar. Edhe pse në të kaluarën nuk kam qenë vendimmarrës për mënyrën se si është caktuar menaxhimi nga komuniteti turk, kjo është një çështje që duhet trajtuar me seriozitet. Sot, kemi mundësi të diskutojmë dhe të mendojmë për një plan të ri. Mund të organizojmë një vizitë në terren për të parë gjendjen aktuale të objektit dhe problemet konkrete. Kemi informacione për dëmtime të brendshme, përfshirë edhe në banjo dhe hapësira të tjera, dhe është e nevojshme të mendojmë një zgjidhje me kosto sa më të ulët për renovim, në mënyrë që qendra të vihet në funksion të plotë. Përkundër vështirësive, Komuna gjithmonë ka përmbushur obligimet e veta, pavarësisht qeverisjes së kohës. Po të mos ishin paguar ato detyrime, qendra mund të ishte mbyllur. Unë nuk dua të më kuptoni sikur kam ndonjë qëllim për përplasje apo kritika ndaj dikujt – jam këtu që të bashkëpunojmë dhe të gjejmë një zgjidhje të qëndrueshme. Besoj se gjatë këtij diskutimi do të dalim me veprime konkrete për të ardhmen. Kjo është ndoshta e vetmja qendër e këtij lloji në gjithë rajonin e Kosovës, dhe është e rëndësishme që Mitrovica ta ruajë dhe zhvillojë më tej këtë aset të çmuar. Mund të bëhet një model për përfshirjen dhe integrimin e komuniteteve që nuk kanë pasur shumë hapësira për zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Pres me interes edhe diskutimet nga kolegët, në mënyrë që bashkërisht të arrijmë në një zgjidhje më të mirë për menaxhimin e kësaj qendre. Nëse dikush nga kolegët ka ndonjë informacion më të detajuar, ju lutem ndaje me ne.

Agron Jashari: Gjatë këtij bashkëbisedimi, nxora disa drejtime që lidhen me të drejtën për zhvillimin e aktiviteteve në qendër. Megjithatë, thirrja e Kryesuesit që të vlerësohet nëse aty janë mbajtur aktivitete me karakter partiak është shumë e rëndësishme. Nëse kemi të bëjmë me të ardhmen e kësaj qendre, atëherë duhet të kemi një qasje të kujdesshme dhe të përgjegjshme. Ajo që është e qartë, është se kjo qendër nuk ka funksionuar si duhet. Ka pasur përpjekje që të kthehet në një hapësirë me karakter të ngushtë komunitar, madje është perceptuar si e lidhur vetëm me një komunitet të caktuar. Ndërkohë që qëllimi i saj i parë ka qenë që të jetë një qendër për të gjitha komunitetet e Mitrovicës, si një hapësirë bashkëpunimi e gjithëpërfshirëse. Problemi më i madh ka qenë menaxhimi i dobët nga komuniteti që është marrë me të. Kemi dokumentacion dhe vëzhgime që e vërtetojnë këtë. Nuk ka pasur qartësi në udhëheqje, ndërsa drejtoria kompetente ka pasur më shumë qartësi, por nuk është ndërmarrë një drejtim i qartë për zgjidhje. Nga diskutimet tona del që në disa raste është lënë përshtypja sikur Komuna nuk ka pasur autoritet të plotë mbi këtë qendër. Por ligjërisht, nëse objektet janë publike dhe mirëmbahen nga komuna, atëherë edhe përgjegjësia menaxheriale bie mbi komunën. Mendoj se duhet organizuar një vizitë në qendër, së bashku me përfaqësues të organizatave që veprojnë aty. Një nga këta është z. Ylir Draxhi, dhe do të ishte me vlerë të diskutonim bashkërisht për të ardhmen e kësaj hapësire. Është përmendur se kjo qendër është financuar vetëm nga komuniteti turk, por realiteti tregon që ka pasur edhe bashkëfinancim nga Komuna dhe donatorë të tjerë. Ndërkohë, gjatë ndërtimit të objektit ka pasur ndryshime që nuk janë miratuar ose evidentuar qartë, përfshirë ndërhyrje në ndërtim që mund të jenë edhe të kontestuara ligjërisht. Gjithashtu, është ngritur çështja e parcelës pas objektit, që dyshohet se mund të jetë shfrytëzuar në mënyrë jo të rregullt. Edhe këtu nevojitet qartësi ligjore

dhe fizike – ku fillon dhe ku mbaron prona e qendrës. Mirëmbajtja gjithashtu është një problem serioz. Ka dëmtime të brendshme, si në banjo dhe hapësira të tjera, dhe nuk ka një strukturë të qartë menaxheriale që të kujdeset për to. Pra, është shumë e rëndësishme që të bëjmë një vizitë fizike në qendër – jo vetëm nga ana ime si individ, por edhe nga ana e komitetit në tërësi – për të parë nga afër gjendjen reale dhe për të marrë vendime të mirë informuara. Jemi përballë një situatë ku për rreth 10 vite, nuk ka pasur interes real nga asnjë drejtues komunal për këtë qendër. Kjo është e dhimbshme, sepse kemi të bëjmë me një qendër që ka potencial të madh për gjithë komunitetet e qytetit tonë. Në fund, dua të theksoj që problemi më i madh lidhet me mungesën e një organogrami të qartë dhe menaxhimi të përgjegjshëm. Kjo duhet të adresohet në mënyrë të strukturuar, përmes planeve konkrete dhe me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara.

Fahri Jashari: Realisht, jam këtu që bashkërisht ta trajtojmë këtë objekt, i cili tashmë i ka mbi dhjetë vite ekzistencë, por fatkeqësisht nuk është trajtuar seriozisht deri më sot. Le të bëhemi bashkë pjesë e një zgjidhjeje të përbashkët. Në momentin kur më janë ofruar faturat për shërbimet komunale, unë i kam përmbyllur të gjitha obligimet. Ata që janë në qendër e dinë shumë mirë këtë – mund ta konfirmojnë – që çdo faturë është shlyer. Por gjithmonë kam pritur që të fillojë diçka më konkrete, që ky objekt më në fund të shfrytëzohet në mënyrë të drejtë nga të gjitha komunitetet. Nuk dua të hyj në detaje që janë përmendur më herët, pasi nuk kam qenë pjesë e ekzekutivit në atë kohë kur është pranuar teknikisht objekti apo kur është ndarë parcela. Por e dimë që objekti është ndërtuar në pronë komunale, dhe për këtë arsye Komuna ka marrë pjesë edhe në financim. Ekziston, sigurisht, një marrëveshje ndërmjet Ministrisë dhe Komunës për ndërtimin e objektit. Besoj që kjo marrëveshje duhet të jetë në arkivën e Komunës ose në DKRS, edhe pse nuk kemi arritur ende ta gjejmë. Jo se ka munguar interesimi për këtë çështje – përkundrazi – por duket që nuk i është kushtuar rëndësia e duhur për shumë vite. E kam vizituar objektin edhe para se të isha drejtor. E di që gjatë verës, por edhe gjatë dimrit, është shfrytëzuar shumë pak. Në disa raste kemi gjetur sallat të zbrazëta, objektin të mbyllur dhe pa asnjë aktivitet. Për këtë situatë, mendoj se përgjegjësinë kryesore e mbajnë ata që kanë qenë të përfshirë në menaxhimin e qendrës. Por ne jemi këtu sot për të mos përsëritur gabimet e së kaluarës. Qëllimi është të gjejmë një zgjidhje të përbashkët, dhe ky objekt të shndërrohet në një model për të gjitha komunat tjera të Kosovës. Mbështetjen e Komunës dhe të drejtorisë përkatëse do ta keni. Çdo veprim që është i mundshëm ligjërisht dhe që na lejon të ndërhyjmë për mirë, jam i gatshëm ta përkrahi. Duhet të ndryshojmë mënyrën se si është menaxhuar kjo qendër deri tani, sepse, le ta pranojmë, nuk ka qenë mënyrë e duhur. Kam parë raste konkrete – sidomos nga komuniteti ashkali – që nuk janë lejuar të zhvillojnë aktivitetet e tyre. Janë mbajtur jashtë objektit, në të ftohtë, nën shi. Kjo është e papranueshme për një qendër që supozohet të jetë për të gjithë. Ky nuk është një problem që nuk i intereson askujt. Përkundrazi, ne jemi këtu sepse na intereson dhe duam një zgjidhje të drejtë. Nuk është me rëndësi kush e menaxhon, por mënyra si menaxhohet. Qendra duhet të jetë e hapur, të ketë aktivitete, të ketë qëndrueshmëri. Jo që një ditë është e hapur, e më pas 11 ditë qëndron e mbyllur. Dhe pastaj të dëgjojmë justifikime si “nuk kemi rrymë” apo “nuk kemi ujë”. Unë e di se ato kërkesa janë bërë, dhe të gjitha – për rrymë, ujë dhe obligime komunale – janë mbuluar. Tash është koha të mendojmë përtej pagesave. Të mendojmë për menaxhim real, për mirëmbajtje të rregullt, për një organogram të qartë dhe për funksionim të qëndrueshëm.

Si komitet, si anëtarë të asamblesë, si drejtori – duhet të jemi të gjithë bashkë në këtë proces. Jam i hapur edhe për një vizitë të përbashkët në objekt, edhe për t'u afruar më shumë me përfaqësuesit e organizatave aty, por edhe për të dhënë rekomandime konkrete për një menaxhim më të mirë.

Agron Jashari: Në këtë periudhë, përderisa nuk ka një menaxhim të qartë dhe të përhershëm, është e vështirë që të organizohen dhe zhvillohen aktivitetet në mënyrë të mirëfilltë në këtë qendër. Aktivitetet që zhvillohen aktualisht janë, për shembull, ato të grave, të cilat organizohen dy herë në javë dhe kanë orarin e përcaktuar, zakonisht për tre ose katër orë. Edhe pse nuk ka një orar të rregullt për të gjithë aktivitetet, këto gra vazhdojnë të përdorin ambientet dhe përpiqen t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre. Një aktivitet tjetër i rëndësishëm është ai i Shoqatës Kulturo-Artistike të Junikut, e cila mban valle dhe ushtron aktivitetet e saj rregullisht në orën pesë deri në shtatë pasditeve. Por për të pasur një funksionim të rregullt, menaxhimi duhet të jetë gjithmonë prezent gjatë këtyre aktiviteteve. Në rast të mungesës së menaxhimit dhe të administratës përgjegjëse, aktivitetet e organizuara nuk mund të kenë rrjedhshmëri dhe as siguri. Është e rëndësishme që të ketë një bashkëpunim të ngushtë mes menaxhmentit të qendrës dhe pjesëmarrësve në aktivitetet e ndryshme. Nuk duhet të kemi situata ku mungon prezenca e administratorëve ose të përgjegjësve të qendrës, sepse atëherë është e vështirë të zgjidhen çështjet që dalin gjatë aktiviteteve. Unë besoj se zgjidhja më e mirë do të ishte që Kuvendi i komunitetit, ose organi përkatës, të marrë vendime të qarta lidhur me funksionimin e qendrës, të përcaktojë rregulla dhe orare, dhe t'i komunikojë ato qartë të gjithë përdoruesve. Për më tepër, është thelbësore që të krijohet një ambient besimi, ku të gjithë kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të shfrytëzojnë qendrën në mënyrë të barabartë, pa pengesa dhe pa diskriminim. Kjo nuk duhet të shihet si çështje personale apo politike, por si një punë e përbashkët dhe një menaxhim profesional që sjell dobi për të gjithë komunitetet që përdorin qendrën. Besoj fuqimisht që si drejtori, ashtu edhe si kolegë, do të bëjmë hapa konkretë dhe të duhur për të ecur përpara dhe për të sjellë një menaxhim të organizuar dhe efikas të kësaj qendre.

Xhafer Preteni: Gjatë këtyre bisedimeve, unë po përpiqem të kuptoj gjithçka dhe po e pasqyroj me dokumente. Por realisht, pa dokumentacion të plotë, nuk mund të ndërmarrim hapa të mtejshëm. Nuk mund të veprojmë mbi supozime ose pa qartësi. Për të kompletuar këtë situatë, duhet të dimë: A ekziston një statut zyrtar për këtë qendër?, A ka një organogram të miratuar dhe a ka një menaxhment të caktuar apo ka pasur dhe është shpërbërë?

Jeton Rrahmani: Kështu siç e diskutuam edhe me znj. Elidiana, por edhe bazuar në komentet e secilit prej jush, po shihet qartë që ka një përputhje idesh dhe qëndrimesh. Është e qartë që Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport duhet të marrë një rol më të theksuar në këtë proces – dhe nuk e vë në dyshim as vullnetin e drejtorit për të trajtuar këtë çështje me seriozitet. Është më e lehtë për ne që e shohim situatën nga jashtë të konstatojmë problemet, por zgjidhjet vijnë më lehtë kur procesin e udhëheq një bartës i qartë – dhe kjo në këtë rast duhet të jetë drejtoria përkatëse, me ndihmën e të gjithë neve. Hapi i parë është të sigurojmë dokumentacionin bazë, duke filluar nga: marrëveshjet mes Ministrisë dhe Komunës, vendimet eventuale të kryetarit apo strukturave të tjera që kanë ndarë objektin në menaxhim, dhe çdo dokument që ndodhet në arkiva apo zyra komunale. Pasi t'i kemi këto dokumente përpara vetes, atëherë mund të diskutojmë dhe vendosim në mënyrë më të informuar. Nuk është e udhës që të vendosim në mënyrë të njëanshme ose pa informacione të plota. Është shumë e rëndësishme që në këtë proces të përfshihen të gjithë aktet, duke filluar nga ata që aktualisht janë pjesë e qendrës dhe që zhvillojnë aktivitetet atje. Duhet të dëgjohet edhe mendimi dhe përvoja e tyre, sepse janë pjesë e drejtpërdrejtë e funksionimit të objektit. Si propozim konkret, do të ishte mirë që të formohet një komision i përbashkët, i cili të përfshijë edhe anëtarë të kuvendit Komunal, përfaqësues nga drejtoria dhe komunitetet, me qëllim të hartimit të një plani strategjik për funksionimin e qendrës, përcaktimit të strukturës menaxhuese dhe përgjegjëse, rregullimit të aspektit buxhetor dhe administrativ, dhe pse jo, artimit të një kalendarit vjetor të aktiviteteve, ku çdo organizatë të ketë të qartë kur, si

dhe me çfarë programi do të veprojë në hapësirë. Këto veprime do ta kthenin qendrën në një hapësirë funksionale, transparente dhe në shërbim të të gjitha komuniteteve. Mendoj se këto mund të dalin si rekomandim përfundimtar nga ky takim, natyrisht nëse ka mbështetjen e shumicës sonë këtu. Atëherë unë duke u bazuar në diskutimet që kemi zhvilluar sot, propozoj që të dalim me disa veprime konkrete deri në takimin e ardhshëm, i cili mund të mbahet gjatë muajit që vjen. Takimi i ardhshëm do të ishte mirë të mbahet pasdite, diku rreth orës 14:00, në mënyrë që të kemi më shumë hapësirë për diskutim dhe të mos jemi të kufizuar në kohë. Në atë takim, drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport do të vijë me informatat e kërkuara, përfshirë edhe statutin apo dokumentacionin që lidhet me funksionimin e objektit. Gjithashtu, kërkojmë nga përfaqësuesit e komuniteteve që operojnë në atë objekt, që të sjellin në takim kryetarët e organizatave përkatëse, të cilët do të na ofrojnë një njoftim zyrtar mbi aktivitetet që zhvillohen, sfidat, dhe pjesëmarrjen aktuale në qendër. Në ndërkohë, do të ishte e udhës që të shqyrtojmë mundësinë e formimit të një komisioni të përbashkët, i cili do të punonte në një plan menaxhimi dhe zhvillimi për qendrën, që përfshin: – strukturën organizative, menaxhimin, aspekte buxhetore, dhe një kalendar të qartë të aktiviteteve. Atëherë unë propozoj që të hedhim në votim rekomandimin të cilin e përpiluam.

Rekomandimi: Të organizohet një vizitë dhe takim i përbashkët në Qendrën e Komuniteteve, ku do të marrin pjesë të gjithë akterët përkatës: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përfaqësuesit e Komitetit për Komunitete, Zyra për Komunitete, organizatat që operojnë aktualisht në objekt, si dhe përfaqësues nga Kuvendi Komunal ose drejtoritë tjera relevante. Qëllimi i takimit është vlerësimi real i gjendjes aktuale dhe nisja e një procesi për sigurimin e një menaxhimi funksional dhe aktiviteteve të duhura në shërbim të të gjitha komuniteteve.”

Komiteti për Komunitete u pajtuan unanimitisht me rekomandimin e propozuar.


Atëherë me këtë, na mbetet që të veprojme konkretisht në hapat e ardhshëm. Ju faleminderit për kontributin dhe pjesëmarrjen!

Mbledhja përfundoj punimet në ora 16:00 min.

Mitrovicë
27.02.2025

Procesmbajtës:

Atërdita MAXHUNI

Kryesuesi i Komitetit

Jeton RRAHMANI